




REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 86/15

Nr. i fq. / Br. st -5-

Data: / Datum 30.04.2015

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**RREGULLORE  
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË DHE SHPËRBLIME PËR NXËNËS  
TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË**

PRILL 2015

Bazuar në Nenin 12 paragrafi 2 pika (c) lidhur me nenin 17 pika (s) të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dhe Nenin 41 paragrafi 2 pika (c) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrri, në seancën e mbajtur më **30 prill 2015**, miratoi këtë:

## **R R E G U L L O R E**

### **për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblime për nxënës të Komunës së Vushtrrisë**

#### **Neni 1** **Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret, kohëzgjatja e realizimit të bursës, lartësia e bursës dhe procedura për ndarjen e bursave për studentë/e, të cilët studiojnë në universitetet publike të Republikës së Kosovës dhe shpërblime për nxënës që vijnë në mësimin në shkollat e Komunës së Vushtrrisë.

#### **Neni 2** **Fushëveprimi**

1. Komuna e Vushtrrisë, varësisht nga mjetet financiare që ka në dispozicion, ndan bursa për studentë/e dhe nxënës të Komunës së Vushtrrisë;
2. Bursat dhe shpërblimet ndahen për periudhën kohore nga 1 tetori deri më 30 shtator të vitit vijues akademik.

#### **Neni 3** **Përfituesit e bursës**

1. Të gjithë studentët/et e rregullt/a, pa kurrfarë dallimesh etnike, gjinore, racore, fetare, sociale dhe politike, që janë të regjistruar në fakultete të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave të studimeve;
2. Të gjithë nxënësit e shkollave të mesme të larta, të cilët kanë arritur rezultate të mira në nivel regjional dhe shtetëror;
3. Përparësi në fitimin e së drejtës për bursë do të kenë studentët/et që studiojnë në drejtimet deficitare;
4. Drejtimet deficitare përcaktohen me konkurs nga Drejtoria për Arsim;
5. Numri i bursave caktohet me konkurs për të gjitha kategoritë.

**Neni 4**  
**Përfituesit e bursës me automatizëm**

1. Përfituesit e bursës nga viti paraprak, iu vazhdohet me automatizëm, nëse i/e njëjti ofron dëshmi të përfundimit të vitit akademik me sukses dhe me notën mesatare prej 7.5 e sipër.
2. Për këtë kategori nuk shpallet konkurs.

**Neni 5**  
**Bursat për fëmijët e dëshmorëve**

Fëmijët e dëshmorëve bursën e përfitojnë nga viti i parë i fillimit të studimeve universitare.

**Neni 6**  
**Caktimi i numrit të ndarjes së bursave**

Kryetari i Komunës merr vendim për numrin e bursave që do të ndahen sipas drejtimeve të studimeve, si dhe shumën financiare për një bursë, e që ndahet për një vit akademik -shkollor.

**Neni 7**  
**Formimi dhe përbërja e komisionit**

1. Bursat për studentë/e dhe shpërblime për nxënës do të ndahen nga komisioni i formuar me vendim të Kryetarit të komunës.
2. Komisioni do të jetë i përbërë nga 5 anëtarë, (2 nga Drejtoria e Arsimit, 1 jurist me përvojë nga komuna, 2 nga Kuvendi komunal- njëri nga opozita).

**Neni 8**  
**Shpallja e konkursit**

1. Drejtoria e Arsimit do të shpallë konkurs për ndarjen e bursave. Konkursi duhet të jetë i shpallur në njërin nga gazetatat e shtypit ditor, në ueb-faqen zyrtare të komunës, si dhe në tabelën e shpalljeve që do të qëndrojë i shpallur për 15 ditë;
2. Në konkurs do të përcaktohet dokumentacioni i kërkuar dhe informatat tjera të nevojshme.

**Neni 9**  
**Detyrat e Drejtorisë së Arsimit**

Drejtorja e Arsimit obligohet që t'i kryejë punët e domosdoshme tekniko-administrative që rrjedhin nga natyra e punës së komisionit, si dhe punët rreth shpalljes së konkursit, pranimit të kërkesave, formulimit të kontratave e të ngjashme.

## **Neni 10**

### **Kushtet për përfitimin e bursës**

1. Për realizimin e të drejtës së bursës dhe shpërblimit, kandidatët /et duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:

- 1.1. Të jenë banorë rezident të Komunës së Vushtrrisë;
- 1.2. Të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa;
- 1.3. Të kenë certifikatën e notave;
- 1.4. Të mos jenë shfrytëzues/e të ndonjë burse tjetër;
- 1.5. Të mos jenë të punësuar;
- 1.6. Të paraqesin dëshmi për gjendjen ekonomiko-sociale të familjes;
- 1.7. Gjendja ekonomiko-financiare e familjes e kandidatit/es vërtetohet në bazë të dëshmive të lëshuara nga Qendra për Punë Sociale në Vushtri. Komisioni ruan të drejtën që të hulumtojë dhe vërtetojë gjendjen reale ekonomiko-financiare të kandidatit/es.

2. Nxënësit duhet të dëshmojnë me vërtetim se janë nxënës vijues të njëres nga shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë.

## **Neni 11**

### **Kriteret për përfitimin e bursës**

1. Për suksesin e arritur në mësim në vitin paraprak, kandidati/ja vlerësohet me pikë si në vijim:

- 1.1. Studenti/ja me notë mesatare mbi 9 (nëntë), vlerësohet me 30 pikë;
- 1.2. Studenti/ja me notë mesatare mbi 8 (tetë), vlerësohet me 20 pikë;
- 1.3. Studenti/ja me notë mesatare mbi 7.5 (shtatë pikë pesë), vlerësohet me 15 pikë;
- 1.4. Studenti/ja nga familja e martirëve, veteranëve, invalidëve, vlerësohet me 10 pikë;
- 1.5. Studenti/ja nga familja e të burgosurve politik, vlerësohet me 10 pikë;
- 1.6. Studenti/ja në asistencë sociale, vlerësohet me 10 pikë;
- 1.7. Studenti/ja me studime në drejtimet deficitare, vlerësohet me 10 pikë;
- 1.8. Studenti/ja që studiojnë së bashku me një anëtar/e nga e njëjta familje, vlerësohet me 10 pikë;
- 1.9. Studenti/ja, i cili nuk i ka prindërit në jetë, vlerësohet me 10 pikë;

1.10. Studenti/ja me nevoja të veçanta, vlerësohet me 15 pikë;

1.11. Studenti/ja dhe nxënësi/ja që ka marrë mirënjohje apo certifikatë (shtetërore, kombëtare ose ndërkombëtare) që ka arritur rezultate të larta, duke zënë njërin nga tri vendet e para në ndonjë garë-konkursi në lëmin arsimor, vlerësohet me 20 pikë;

1.12. Studenti/ja që ka likuiduar vitin paraprak me afat të rregullt vlerësohet me 5 pikë.

2. Në kushtet dhe kriteret e njëjta të cekura në nenin 9, do të kenë përparësi studentët e familjeve të viktimave civile të luftës, të veteranëve, të invalidëve të luftës, të gjinisë femërore.

## **Neni 12** **Detyrat e komisionit**

Pas skadimit të afatit të konkurrimit, komisioni do të bëjë vlerësimin e kërkesave. Gjatë procedurës së vlerësimit të kërkesave, komisioni do të përcaktojë metodën e punës dhe mënyrën e seleksionimit të kërkesave, gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

## **Neni 13** **Hartimi dhe publikimi i listës së përfituesve të bursës**

1. Pas përfundimit të procedurës së seleksionimit, komisioni do të hartojë listën e përgjithshme të kandidatëve/eve përfitues/e të bursës;

2. Lista e përfituesve do të shpallet publikisht dhe do të vendoset në tabelën e shpalljeve të komunës.

## **Neni 14** **E drejta e ankesës**

1. Kundër vendimit për shpalljen e listës së përfituesve të bursave nga Komisioni përndarjen e bursave, lejohet ankesa, e cila i drejtohet Komisionit të ankesave, i formuar “ad-hoc” me vendim të Kryetarit të komunës;

2. Ankesa ushtrohet në afat prej tetë (8) ditëve nga dita e shpalljes e listës së përfituesve të bursave nga ana e komisionit;

3. Komisioni për shqyrtimin e ankesave, në afat prej 15 ditësh duhet të vendosë lidhur me ankesën e ushtruar.

## **Neni 15** **Obligimet e përfituesve të bursës**

1. Me përfituesit/et e bursave do të lidhet kontrata, e cila do të nënshkruhet nga drejtori i arsimit dhe përfituesi/ja i/e bursës;

2. Nëse nuk nënshkruhet kontrata nga ana e studentit/es brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e njoftimit të kandidatit/es përfitues/e të bursës, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga bursa dhe përfitues do të jetë kandidati që është në listë sipas radhës;

3. Kohëzgjatja për dhënien e bursës, obligimet e përfituesit/es të bursës dhe kushtet tjera do të përcaktohen me kontratë.

### **Neni 16** **Procedurat e pagesës**

1. Mjetet financiare do të alokohen gjatë vitit fiskal në xhirollogaritë bankare të përfituesve, në bankën të cilën studenti/ja e ka përzgjedhur;

2. Drejtoria kompetente për financa dhe Drejtoria kompetente për arsim, janë të obliguara të kujdesen për alokimin dhe zotimin e mjeteve të cekura më lart, në afatin kohor.

### **Neni 17** **Dispozitat shfuqizuese dhe ndryshuese**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon të vlejë Rregullorja Nr. 185/13, dt. 25.07.2013 për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblimeve për nxënës.

2. Kjo rregullore mund të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

### **Neni 18** **Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje**

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje obligohet Drejtoria për Arsim.

### **Neni 19** **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës së Vushtrrisë.

**Shpëtim Zhegrova**  
  
**Kryesuesi i Kuvendit**